



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.21, datë 16.01.2023

PËR
“FILLIMIN E PROCEDURAVE TË RISTRUKTURIMIT TË ADMINISTRATËS
SË KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË”

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 178 pika 2, 176 pika 4 të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, ligjin Nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligjin Nr.84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, nenin 50, pika 3 të ligjit Nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, Udhëzimin Nr.1, datë 01.03.2016, “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit” i ndryshuar, si dhe relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni për Planifikimin Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Fillimin e procedurave të ristrukturimit të administratës së Këshillit të Lartë të Prokurorisë.
2. Ngarkohet Kryetari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Sekretari i Përgjithshëm, për ngritjen e komisionit të ristrukturimit.
3. Të njoftohen për këtë vendim punonjësit e administratës së Këshillit të Lartë të Prokurorisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
5. U shpall në Tiranë, sot më 16.01.2023.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETAR
Alfred Balla

ZV/KRYETAR
Tartar Bazaj

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Bujar Sheshi

ANËTAR
Nurihan Seiti

ANËTAR
Eloida Goxhi

ANËTAR
Esmeralda Keshi

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Mirëla Bogdan

ANËTAR
Arta Mandro

ANËTAR
Ledina Riza

